



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

## KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

616-23-4400-2-2-1/C1203

**KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe  
Enver Berisha B.I., Siqeve, Prishtine, (ne vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin  
një kontrate publike për Shërbimet në vijim:

### Transporti i nxënësve dhe arsimtarëve për viset rurale

#### Lloto 2 Prishtinë-Llukare -Siqeve dhe anasj

Nr1 i prokurimit	616-23-4400-2-2-1
Nr i brendshëm	616 -23-099-221

Neni 1              Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim: **Transporti i nxënësve dhe arsimtarëve për viset rurale-Lloto 2 Prishtinë-Llukare -Siqeve dhe anasj.**

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve qe duhet te performohen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me datën e percaktuar ne planin e menaxhimit dhe përfundon në një periudhë prej maksimum 12 muajsh

Neni 2              Koha e përfundimit

2.1 Kohëzgjatja e kontratës është 12 muaj

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë Prishtinë

<sup>1</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

### **Neni 3 Çmimi**

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Vlera totale indikative e kontratës është 14,700.00 Euro. Derivimi i lejuar nga vlera totale indikative është [+ - 30%]

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësive do të janë fiksë dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

### **Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës**

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknikë;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.


### **Neni 5 Komunikimet**

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kérkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshtësia në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetoj", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhet Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues	Për Kontraktuesin
Visar Shehu	Emri: <i>MINIBUS Enver Berisha</i>
Udhëheqës i Prokurimit	Pozita: <i>Prokuror</i>
	Nënshkrimi <i>[Signature]</i>
21.06.2023	Data: <i>21.06.2023</i>
	Vula: 

### KUSHTET E PËRGJITHSHME

#### Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofroesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofroesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofroesit të Shërbimeve.

1.3 "Ofroes i shërbimeve" është Operatori Ekonomik ose grapi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 "Personeli" do të thotë personat e angazhuar nga Ofroesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 "Çmimi i kontratës" do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 "Nënkontraktuesi" do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofroesi i Shërbimeve.

1.7 "Palë" nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofroesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 "Autoriteti Kontraktues" nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 "KPK" nënkuption Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" nënkuption Kushtet e Veçanta të Kontratës.

**Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm**

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

**Neni 3 Transferimi**

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofroesit i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofroesit i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përvèç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofroesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënisë së të drejtës së Ofroesit të Shërbimeve siguruesve të Ofroesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofroesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofroesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënen e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

**Neni 4 Nën-kontraktimi**

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofroesit i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjesë të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertes. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontrates, Ofroesit i Shërbimeve duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofroesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofroesit i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përmblushin kërkesa e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofroesit i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofroesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjesë të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofroesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

**Neni 5 Tatimi**

5.1 Ofroesit i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përpunhje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritur të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit te shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do tē lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyrimeve doganore nē qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë nē vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

#### Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet tē fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marres së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do tē përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar nē Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet nē datën e caktuar, ai do tē jetë përgjegjës për tē paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do tē jetë data e përfundimit te gjitha aktivitetave.

#### Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund tē kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do tē vonohet, për ndonjëren nga këto arsy:

- a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për tē përmembushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë madhore siç përcaktohet nē nenin 8;

7.2 2 Brenda 15 ditëve me tē kuptuar se një vonesë mund tē ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do tē njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që tē bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për tē cilën ai konsideron se ka tē drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjtë pikë nē kohë tē sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi tē plotë nē mënyrë që tē mund tē shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive tē përmendura nē 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë tē njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund tē arsyetohet, ose nē mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose tē informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka tē drejtë nē zgjatje.

#### Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje tē obligimeve tē saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve tē tillë parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë madhore që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënien tē kontratës ose kur kontrata hyn nē fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do tē thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrrëgullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin tē deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetat, shtrëngatat, vetëtimi, vërvshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtëj kontrollit tē palëve dhe nuk mund tē përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do tē marr tē gjitha masat e arsyeshme për tē mënjanuar paaftësinë e një pale tē tillë që tē përmembush detyrimet e saj tanë e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do tē jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërpërje nēse vonesa e tij nē realizimin ose dështimi për tē realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje tē forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do tē jetë i detyruar tē paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërpërje nēse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për tē kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrëthanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund tē ndikojë nē realizimin e obligimeve tē saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë tē dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrëthanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do tē vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe tē angazhojë tē gjitha mjetet e arsyeshme alternative për tē plotësuar ndonjë

obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tillë alternative përvëç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

#### Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përvëç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje l'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zgjegjuar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përsaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpert kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve

humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

#### Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

#### Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofrues i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtrej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmët e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të batojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të janë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbëria e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuara në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

#### Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do tē ofrojë ofruesit tē shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund tē jenë relevante pér zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues nē fund tē periudhës së zbatimit tē detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do tē bashkëpunojë sa më shumë tē jetë e mundur me ofruesin e shërbimit pér tē siguruar informacion që ky i fundit mund tē kërkojë nē mënyrë tē arsyeshme pér tē kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do tē caktoj "Menaxherin e Projektit", i cekur nē KVK, i cili do tē jetë përgjegjës pér mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe pér raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

#### Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizoje ndonjë ose tē gjitha sherbimet brenda limiteve kohore tē specifikuara nē kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njofitim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera tē tij sipas kontratës, do tē ketë tē drejtë, pér secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit tē periudhës së kontratës dhe datës aktuale tē përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara tē barabarta me 0,25% nē ditë tē vlerës së shërbimeve tē pa kryera deri nē një maksimum prej 10 % tē vlerës totale tē porosise. Autoriteti Kontraktues mund tē zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofruesit te Shërbimeve. Pagesat e dëmeve tē likuiduara nuk do tē prekin detyrimet e Ofruesit te Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm tē shërbimeve nē tërësi, dëmet e likuiduara tē parapara nē paragrafin 13.1 do tē llogariten nē bazë tē vlerës totale tē porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar tē drejtën tē kërkojë së paku 10 % tē vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njofojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve tē:

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;
- te ndërpresë kontratën, dhe nē këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do tē ketë tē drejtë pér kompensim; dhe
- tē hyjë nē një kontratë me një palë tē tretë pér dhëni e pjesës së mbetur tē shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do tē paguhet pér këtë pjesë tē kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do tē jetë i detyruar tē paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosine, dhe nē këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do tē ketë tē drejtë pér kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do tē jetë i detyruar tē paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur tē Operatorëve Ekonomik tē kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoritetet e tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe nē këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do tē ketë tē drejtë pér kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do tē jetë i detyruar tē paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi tij; dhe
- te njofoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin pér sjellje tē keqe tē Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe tē konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, tē garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoritetet e tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njofoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin pér sjellje tē keqe tē Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe tē konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, tē garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe nē këtë rast Ofruesi i shërbimeve nuk do tē ketë tē drejtë pér kompensim. Ofruesi i

Sherbimeve gjithashtu do tē jetē i detyruar tē paguajē koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe

- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur tē Operatorëve Ekonomik tē kontratës publike kornizë.

#### Neni 14      Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do tē, jo më vonë se dita e nënshkrimit tē kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri pér ekzekutim tē plotë dhe tē mire tē kontratës. Shuma e sigurisë do tē saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do tē ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues pér çfarëdo humbeje që është pasojë e mosekzekutimit tē plotë dhe tē duhur tē obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit tē Shërbimeve.

14.2 Garancioni do tē vazhdojë tē mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit tē Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit tē kontratës do tē jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

#### Neni 15      Sigurimi që do tē merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do tē marr dhe do tē ruaj, dhe do tē shkaktoj Nënkontraktorët tē marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë tē kushteve tē miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe pér mbulim, siç do tē specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë tē Autoritetit Kontraktues, do tē ofroj dëshmi pér Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

#### Neni 16      Parimet tē përgjithshme tē pagesave

16.1 Pagesat do tē bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do tē bëhen në llogarinë bankare tē dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës pér pagesë, duhet tē përdoret pér t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet tē paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në tē cilën kërkesa e pranueshme pér pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do tē jetë data në tē cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa pér pagesë nuk do tē jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund tē pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa pér pagesë nuk mund tē plotësohet sepse shuma nuk do tē paguhet pér shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund tē mos jetë legitim. Në rastin e fundit mund tē bëhet një inspektim i menjëhershëm pér qëllim tē kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do tē japë sqarime, modifikime apo informata tē tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do tē llogaritet nga data në tē cilën është regjistruar kërkesa pér pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që tē ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, tē kërkojë interesin pér pagesë tē vonuar me normë tē re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë tē muajit në tē cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë tē përqindjes. Interesi pér pagesë tē vonuar do tē zbatohet pér kohën që kalon ndërmjet datës së afatit tē fundit tē pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në tē cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i jasin tē drejtë Ofruesit tē Shërbimeve që, ose tē mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh pér Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër tē autoriteteve tē tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i

sherbimeve mund tē informojē AQP-ne pēr shkelje tē tilla. AQP-ja mund tē ndalojē autoritetin kontraktues nga pērdomimi i čdo dhe tē gjitha kontratat qendrore publike kornizē tē nxjerra nga AQP.

#### Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit tē Sherbimeve nga Autoriteti kontraktues do tē jenē si nē KV.K. Autoriteti kontraktues do tē kontrollojē punēn e ofruesit tē sherbimeve dhe tē njoftojē atē pēr čdo defekt qē ēshtē gjetur. Kontrolli i tillē nuk do tē ndikojē nē pērgiegjēsitē e ofruesit tē sherbimeve. Autoriteti Kontraktues mund tē udhēzojē ofruesit e sherbimeve tē kērkojnē njē defekt dhe tē zbulojnē dhe provojnē čdo sherbim qē Autoriteti Kontraktues konsideron se mund tē ketē njē defekt. Periudha garantuese e defekteve ēshtē sic eshte definuar nē KV.K.

#### Neni 18 Pērmirēsimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do tē njoftojē ofruesit e sherbimeve pēr čdo Defekt para pērfundimit tē kontratēs. Periudha garantuese e defekteve do tē zgjatet pēr aq kohē sa Defektet tē korrigojet.

18.2 Sa herē njoftimi pēr njē defekt ēshtē dhēnē, ofruesi i sherbimeve duhet tē pērmirēsoj defektin e njoftuar brenda kohēs sē specifikuar nē njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nēse ofruesi i sherbimeve nuk e ka korriguar defektin brenda kohēs sē specifikuar nē njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do tē vlerēsoj koston e korrigjimit tē defektit, ofruesi i sherbimeve do tē paguaj kētē shumē, dhe do pasoj njē dēnim pēr mungesē Ekzekutimi qē llogaritet sic pērshkruhet nē nenin 13.1.

#### Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratēs

19.1 Pala ka shkelē kontratēn nēse nuk arrin tē shlyejē ndonjē nga obligimet e veta me kontratē sic ēshtē cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Nē rastet kur ndodh njē shkelje e kontratēs, pala e dēmtuar do tē ketē tē drejtē pēr kēto kompensime:

- a) dēmet; dhe/apo
- b) ndērprerje tē kontratēs.

19.3 Pērveç masave tē sipērpērmendura, mund tē jepen dēmshpērblime. Ato mund tē jenē:

- a) dēme tē pērgithshme; ose
- b) dēme tē likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dēmeve, pagesat apo shpenzimet qē rezultojnē nga zbatimi i masave tē parapara nē kētē nen do tē zbatohen duke u zbritur nga shumat qē duhet t'i paguhen Ofruesit tē Sherbimeve, nga depozita, ose me pagesē nga siguria.

#### Neni 20 Zgjidhja miqēsore e mosmarrēveshjeve

20.1 Palēt duhet t'i bējnē tē gjitha pērjeke pēr tē zgjidhur nē mēnŷrē miqēsore tē gjitha mosmarrēveshjet qē mund tē ndodhin ndērmjet tyre. Sapo tē shfaqet ndonjē mosmarrēveshje, palēt do ta lajmērojnē njera tjetren me shkrim pēr qēndrimet e tyre nē mosmarrēveshje dhe pēr ndonjē zgjidhje qē ata konsiderojnē se ēshtē e mundshme. Nēse cilado palē e sheh tē dobishme, palēt do tē takohen dhe tē mundohen ta zgjidhin mosmarrēveshjen. Pala do tē i pērgigjet kērkesēs pēr zgjidhje miqēsore brenda 15 ditēsh pas kērkesēs. Periudha maksimale qē jepet pēr arritjen e kēsaj zgjidhje do tē jetē 30 ditēs nga fillimi i procedurēs. Nēse pērpjekja pēr tē arrihet zgjidhje miqēsore dēshthon ose nēse pala dēshthon tē pērgigjet me kohē ndaj kērkesave pēr zgjidhje, tē dyja palēt do tē jenē tē lira tē vazhdojnē nē fazēn e ardhshme tē procedurēs sē zgjidhjes sē mosmarrēveshjes duke e lajmēruar tjetren.

20.2 Nēse procedura e zgjidhjes miqēsore tē mosmarrēveshjes dēshton, palēt mund tē merren vesh tē pēripiqen tē pajtohen pērimes institucionit tē specifikuar nē KV.K. Nēse nuk mund tē arrihet zgjidhja brenda 30 ditēsh pas fillimit tē procedurēs sē pajtimit, secila palēt do tē ketē tē drejtē tē vazhdojē nē fazēn e ardhshme tē procedurēs sē zgjidhjes sē mosmarrēveshjes.

#### Neni 21 Zgjidhja e mosmarrēveshjeve me procedurē gjyqēsore

21.1 Nëse nuk mund tē arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje tē mosmarrëveshjes, secila palë mund tē kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi nē pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

#### Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofroesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërblyej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jete përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofroesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofroesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofroesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo nē emër tē Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofroesi i shërbimeve nē lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel tē drejtat e pronësisë intelektuale tē asaj pale tē tretë.

## KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksiioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe.
Obligimet Autoritetit Kontraktues	e 12.3	Menaxheri i Projektit do te caktohet pas nënshkrimit te kontratës
Siguria ekzekutimit	e 14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është 10% i vlerës totale te ofertës per 13 muaj
Parimet përgjithshme pagesave	të të 16	<p>Kërkesat për pageset do të bëhen për shërbimet e performuara në baza mujore (ex post).</p> <p>Pagesa do të autorizohet dhe do të bëhet nga Autoriteti Kontraktues për shërbimet e performuara ne baza mujore (ex post).</p> <p>Nuk ka pageset paraprake.</p>
Kualiteti i Kontrollit	17.1	n/a
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<b>Komisioni per ndermjësim pranë Ministrise se Drejtësise</b>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	e 21.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <b>Gjykatën Themelore-Prishtinë</b> ose</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përherëshëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin përményrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>

LOT	Data e skadimit te kontrates	Relacioni	Institucioni Shkollor	km' ne dy drejtimet dhe arsimt.	Nr. i moshës	km' me ditore pune	TOTALI
LOT 2	26.05.2022	Prishtinë- Llukare-Siqeve dhe anasj.	"Ganimette Terbeshi"	3	40	26	175

Bartja-deri në shkollë dje bartja nga shkolla në vendnije(nje bartje)

Në kuadër të kontrates duhet përfshihet:

1. Transporti i Nx.pjt gara të ndryshme të diturisë
  2. Transporti i Nx.pjt testin Kombëtar
  3. Transporti i Nx.me rastin e testiminit të seminaturantëve si dje organizimet e ndryshme nga AK, komisionet e mësimdhënësve.
- Transportuesi duhet ti plotëson kriteret teknike për bartje të utilitarave (nxenave)
- Kohën e nisjes dhe të kthimit e caktuarë direktoret e shkollave në marrëveshje me kompanitë.

The stamp contains the following text:  
Favorit  
Perisija  
Prishtina